

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

UNMIK RREG/2005/12
1 mars 2005

RREGULLORE NR. 2005/12

**MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
AUTORIZIMIN E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN PREJ 1 JANARIT DERI
MË 31 DHJETOR TË VITIT 2004**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke pasur parasysh përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes sipas neneve 5.1 (a) dhe (b) dhe nenit 5.2 (c) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh autorizimin përfundimtar të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas nenit 8.1 (c) të Rregullores së ndryshuar nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë për të miratuar Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës,

Duke marrë parasysh shtojcën II të Rregullores së ndryshuar të UNMIK nr. 2001/19 -ut të datës 13 shtator 2001 për "Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë",

Duke marrë parasysh Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 janar 2003 (Ligji nr. 2003/2) e i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 të datë 12 maj 2003,

Bazuar në propozimin për Buxhetin e Kosovës të vitit 2005 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe pas konsultimit të Këshillit Ekonomik dhe Fiskal,

Me qëllim të miratimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe çështjeve të tjera të lidhura me të,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

Neni 1 Përkufizimet

Në këtë Rregullore, përkufizimet që janë përfshirë në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 janë përfshirë sipas referencave, përveç:

“Ndarje” do të thotë shuma ligjërishit e autorizuar e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për një kategori shpenzimi brenda një programi apo qëllimi të veçantë ose, kur qëllimi i veçantë nuk është identifikuar për një kategori shpenzimi të një organizate buxhetore, siç është parashtruar në pasqyrën 1 të kësaj Rregulloreje;

“Tepricë” do të thotë shumat e detyrimeve të pashpenzuara, mjete të veçuara të pashpërndara, mjete të paangazhuara dhe çfarëdo të ardhurash që tejkalojnë shumën e shpenzimeve dhe të detyrimeve të pashpenzuara të bartura nga viti fiskal 2004;

“Detyrime” do të thotë shpenzime të parapara për të cilat i është dorëzuar Thesarit një urdhërpagesë për detyrimin financiar dhe është evidencuar në Regjistrin kontabël të Thesarit, pa marrë parasysh se a i nënshtrohet apo jo detyrimin ligjor;

“Kategoritë e shpenzimeve” do të thotë rrogat dhe pagat, mallrat dhe shërbimet e tjera, subvencionet dhe transferimet, shpenzimet kapitale dhe rezervat;

“Shpenzime” do të thotë pagesa parash prej Fondit të Konsoliduar të Kosovës;

“Alokimi i fondeve” do të thotë shuma maksimale e shpenzimeve dhe e detyrimeve që mund të bëhen për ndarje të caktuar, sipas këshillës së dhënë një organizate buxhetore në fletënjoftimin e fondeve të lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë;

“Buxhet i Përgjithshëm i Kosovës” do të thotë buxheti i cili përfshin buxhetet e pakonsoliduara të të gjitha organizatat buxhetore të Kosovës në sektorët e aktiviteteve të Qeverisë, që përfaqësohen nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (duke përfshirë komunitat) dhe kompetencat e rezervuara, si dhe ndarjet të cilat janë paraqitur në paqyrën 1 të kësaj Rregulloreje;

“Organizatrat buxhetore me kompetenca të rezervuara” do të thotë organizatat buxhetore që pranojnë shuma të caktuara sipas tabelës B të pasqyrës 2 të bashkëngjitur kësaj Rregulloreje;

“Fitime të mbajtura” do të thotë shuma e mjeteve të pandara që mbesin në Fondin e Konsoliduar të Kosovës nga 31 dhjetori i vitit fiskal paraparak dhe

“Regjistër kontabël i Thesarit” do të thotë regjistri kontabël i themeluar brenda Thesarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 2

Miratimi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2005

Me këtë miratohet Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2005 siç është paraqitur në pasqyrën 1. Ky buxhet mund të ndryshohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të një urdhërese administrative, në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, i miratuar nga Kuvendi si Ligji 2003/2 dhe i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut. nr. 2003/17.

Neni 3

Ndarjet e Buxhetit të Përgjithshëm të Kosovës

3.1 Me këtë autorizohen ndarjet e mjeteve nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për vitin fiskal 2005 siç është paraqitur në tabelën A, B dhe C të pasqyrës 2 që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, dhe shpenzimet e specifikuara në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për qëllimet e përgjithshme të paraqitura të Qeverisë dhe shumat e paraqitura në tabelën A, B dhe C të pasqyrës 2.

3.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresë administrative për të ndryshuar pasqyrat e bashkëngjitura kësaj Rregulloreje në përputhje me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut. nr. 2003/17.

3.3 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë do të mbajë një regjistër të të gjitha ndarjeve të miratuara, transfereve të ndarjeve ose ndryshimeve të tjera të miratuara gjatë vitit fiskal 2005 përmes Regjistrit kontabël të Thesarit, të plotësuar sipas nevojës me shënime të tjera. Me rastin e rishikimit gjashtëmuor të buxhetit të vitit 2005 dhe raportit përfundimtar, i cili përgatitet brenda tre muajsh nga mbyllja e vitit fiskal 2005 ose në raste të tjera sipas kërkesës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose Kuvendit, Ministri i Financave dhe i Ekonomisë duhet t'i paraqesë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, Qeverisë dhe Kuvendit raport gjithpërfshirës së paku dy herë në vit, duke cekur hollësisht dhe duke barazuar ndarjet e miratuara të buxhetit fillestar 2005, të gjitha transferet vijuese dhe ndryshimet tjera dhe ndarjet përfundimtare për vitin fiskal 2005.

Neni 4 Ndarja e mjeteve buxhetore komunale

4.1 Pavarësisht nga neni 3, ndarjet në pasqyrën 2, tabela C, të cilat bazohen në “Burimet financiare vetanake të komunave”, autorizohen vetëm nëse të ardhurat e tilla janë depozituar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe janë regjistruar sipas rregullit në regjistrin kontabël të thesarit.

4.2 Në rastin kur të hyrat nga participimi, pagesat, taksat ose tatimet e mbledhura nga ana e komunës tejkalojnë shumat e ndara të të hyrave në tabelën C të pasqyrës 2 për atë komunë, duhet bërë një ndryshim shoqërues në shumat e ndara në buxhet për atë komunë. Të hyrat e tepërta mund të mos ndahen apo shpenzohen derisa nuk bëhet ndryshim në buxhetin e asaj komune nga ana e Kuvendit Komunal në përputhje me procedurat e përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17. Çdo ndryshim i tillë në të hyra dhe ndarje evidencohet në Regjistrin kontabël të Thesarit dhe përfshihet në rishikimin e ardhshëm të pasqyrave buxhetore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenet 2 dhe 3.

4.3 Të hyrat nga pagesat dhe/ose taksat për arsim evidencohen veçmas dhe këto të hyra mund të ndahen dhe shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime arsimore. Të hyrat nga participimi për kujdesin shëndetësor primar evidencohen veçmas dhe këto të hyra mund të ndahen dhe të shfrytëzohen nga komuna vetëm për qëllime të kujdesit shëndetësor primar.

4.4 Çdo komunë e saktësuar në pasqyrën 4 duhet t’u ndajë bashkësive joshumicë të asaj komune subvencione për arsim dhe shëndetësi nga burimet e të ardhurave të saj vetanake dhe të përgjithshme, që i kanë marrë nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës, së paku në përpjesëtimin që është paraqitur në pasqyrën 3, e cila pasqyrë mund të revidohet periodikisht në bashkërendim me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe kuvendet komunale. Rekomandimet e përbashkëta për çfarëdo ripërmirësimi apo rindarje të përqindjeve duhet të dërgohen nga Zëvendëspërfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile dhe nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për miratim.

4.5 Shpenzimet e paparapara nuk përfshihen për qëllime të përlllogaritjes së ndarjes së drejtë financiare për vetë arsyen e përkufizimit. Kjo nuk vlen për shpenzimet e paparapara të autorizuara veçanërisht për t’i ndihmuar ndonjë komune në përmbushjen e përgjegjësi të saj për ndarje të drejtë financiare.

4.6 Brenda 15 ditësh pas përfundimit të çdo tremujori të vitit fiskal 2005, çdo komunë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një raport në Zyrën për çështjet e komunitetit lidhur me ndarjen e drejtë financiare dhe standardet e objektivat tjera përkatëse.

4.7 Në rast se komuna nuk e përmbush përpjesëtimin e caktuar të ndarjes së drejtë financiare ose nuk u përmbahet standardeve dhe objektivave të tjera përkatëse, Zëvendëspërfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, pasi të jetë konsultuar me Komisionin për subvencione, mund t'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm zbatimin e masave, por që nuk kufizohen vetëm me në to, cilat mund të përfshijnë:

(a) Mosdhënien e shumave të ardhshme nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës, duke përfshirë edhe të ardhurat vetanake të komunës derisa të mos jetë përmbushur përpjesëtimi;

(b) Caktimin e kriterit për komuna për shpenzimin e fondeve në dispozicion;

(c) Bartjen e fondeve të zotuara e të pashpenzuara të komunës për vitin 2005, deri në nivelin e përpjestueshëm me deficitin e shpenzimeve për komunitetet joshumicë në përputhje me përqindjet e përcaktuara në Pasqyrën 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/23, për projekte të posaçme për komunitetet joshumicë në vitin 2004;

(d) Tërheqjen e drejtpërdrejtë të fondeve për bashkësitë joshumicë,

(e) Decertifikimin e komunës në fjalë dhe

(f) Caktimin e një administratori financiar komunal në bazë të nenit 61 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UMNMIK-ut nr. 2003/17, sipas nevojës.

4.8 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë në bashkërendim të ngushtë me Zëvendëspërfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, pasi të jetë konsultuar me Komisionin për subvencione, mund të nxjerrë udhëzime administrative lidhur me administrimin e ndarjes së drejtë të financave nga komunat.

Neni 5

Të hyrat vetanake të organizatave të buxhetit qendror

5.1 Të gjitha të hyrat vetanake për Qeverinë Qendrore që përbëhen, por që nuk kufizohen në pagesat dhe taksat për shfrytëzim, duhet të deponohen në një llogari të veçantë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Në këtë Rregullore, shprehja "pagesat dhe taksat për shfrytëzim" është përkufizuar si pagesa të pranuar nga organizata e buxhetit qendror për mallrat dhe shërbimet e ofruara institucioneve joqeveritare apo personave.

5.2 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar që të nënshkruajë memorandum mirëkuptimi me organizatën buxhetore për të trajtuar:

(a) Procedurat për mbledhjen, harmonizimin dhe depozitimin e të hyrave në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe

(b) Shumën apo përpjesëtimin e të hyrave që do t'i ndahet organizatës buxhetore.

5.3 Organizata buxhetore është përgjegjëse për mbledhjen, depozitimin dhe harmonizimin me thesarin, në përputhje me procedurat në memorandumimin e mirëkuptimit të miratuar paraprakisht. Shuma e autorizuar e ndarjes nuk duhet të tejkalojë vlerën e të hyrave të saktësuara të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

5.4 Të gjitha ndryshimet në të hyra dhe në ndarje që rrjedhin nga ky memorandum i mirëkuptimit duhet të përfshihen në rishikimin e ardhshëm të pasqyrave buxhetore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenet 2 dhe 3.

Neni 6

Ndarja dhe rindarja e mbetjeve dhe e tepriceve të fondeve të bartura përpara

6.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas mbylljes së vitit fiskal 2005, Qeveria i paraqet Kuvendit dhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një pasqyrë fillestare që thekson burimet dhe shumat e përgjithshme të elementeve të fondeve të bartura përpara si suficit i parave nga viti fiskal 2004 duke përfshirë:

(a) Fondet e identifikuar nga buxheti i vitit 2004, të cilët janë të përfshirë në buxhetin e vitit 2005 si fonde të bartura për t'u transferuar në ndarje të plota me para të gatshme në vitin 2005;

(b) Suficitin e papritur të mjeteve vetanake të qeverisë qendrore;

(c) Suficitin e papritur të mjeteve vetanake të komunës;

(d) Suficitin e papritur të granteve nga donatorë të caktuar;

(e) Suficitin e papritur të parave publike të mbajtura nga AKM-ja lidhur me administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të ngjashme

(f) Cilatdo fonde që ruhen si fitime të mbetura.

6.2 Suficitet e papritura të “mjeteve vetanake të komunës” nga viti fiskal 2004 dhe më herët, nëse kanë qenë të depozituara në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe janë të evidencuara në Regjistrin kontabël të Thesarit si mjete të veçuara për komunën, janë ndarë dhe janë autorizuar për vitin fiskal 2005.

6.3 Suficitet e papritura të granteve nga donatorë të caktuar, që janë pranuar dhe janë evidencuar në Regjistrin kontabël të Thesarit në vitin 1999-2004 janë ndarë dhe janë autorizuar për vitin fiskal 2005.

6.4 Në pajtim me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17, të gjitha dhurimet, huatë dhe grantet do të depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës dhe do të konsiderohen si pjesë e tij, përveç rasteve kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pajtohet ndryshe. Pas përfundimit të procedurës së nxjerrë nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe pas depozitimit të tyre në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, dhurimet, huatë dhe grantet e tilla konsiderohen se janë ndarë për qëllim apo qëllime të caktuara dhe mund të ndahen dhe shpenzohen për qëllimin apo qëllimet e tilla, përveç rasteve kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pajtohet ndryshe.

6.5 Të gjitha paratë publike të mbajtura nga AKM-ja lidhur me administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të ngjashme, dhe çdo pagesë nga kapitali themelues i AKM-së, konsiderohen si pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregulloret e UNMIK-ut nr. 2002/12, 2002/13 dhe 2003/13. Paratë e tilla publike të mbajtura nga AKM-ja konsiderohen se janë ndarë për qëllimin apo qëllimet e caktuara, të autorizuar sipas ligjit në fuqi dhe mund të ndahen dhe të shpenzohen për qëllimin apo qëllimet e tilla.

Neni 7

Kufizimet mbi detyrimet dhe shpenzimet

7.1 Shpenzimet nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës ose detyrimet ndaj tij duhet të bëhen vetëm:

- (a) Nga sasia e cila është ndarë për këtë qëllim dhe
- (b) Në pajtim me kushtet e tjera të kësaj Rregulloreje dhe nenit 8 të Ligjit mbi prokurimin publik (Ligji nr. 2003/17) i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/3 të datës 9 shkurt 2004.

7.2 Nga çdo organizatë buxhetore kërkohet të garantojë që numri i personelit të saj të punësuar të mos tejkalojë në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2005 numrat e saktësuar në pasqyrën 2 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.

7.3 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, me këshillimin e Ministrit të Shërbimeve Publike, mund të autorizojë rritjen ose zvogëlimin e numrit të personelit të organizatës buxhetore të saktësuar në pasqyrën 2 që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje. Autorizimi nga ky nen nuk nënkupton as nuk autorizon ndonjë ndryshim në ndarjet për paga dhe rroga. Ndryshimet e tilla do të përfshihen në shqyrtimin e ardhshëm të pasqyrave të buxhetit të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenin 3.

7.4 Mosrespektimi i kufirit lidhur me numrin e stafit është shkelje e kësaj Rregulloreje dhe e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17. Dënimet e parapara me atë ligj shqiptohen në mënyrë strikte ndaj çdo individi i cili është përgjegjës për shkelje të tillë.

Neni 8 Shpenzimet e parapara

8.1 Fondet për shpenzimet e parapara ndahen si:

(a) “Rezervë Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë” në tabelën A të pasqyrës 2 dhe

(b) “Rezervë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm” në tabelën B të pasqyrës 2.

8.2 Shumat e autorizuara për shpenzime të parapara mund të përdoren vetëm për kërkesa urgjente dhe/ose të paparashikuara.

8.3 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë i paraqet Kuvendit raport tremujor mbi shfrytëzimin e shpenzimeve të paparashikueshme.

8.4 Shumat mund të transferohen nga ndarjet e shpenzimeve të paparashikueshme në pajtim me kriteret vijuese:

(a) Transferimet e shumave më të vogla ose barazi me 250.000 euro nga “Rezerva e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë” autorizohen nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, pas pranimit të arsytimit të duhur;

(b) Transferimet e shumave më të mëdha se 250.000 euro nga “Rezerva e Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë” autorizohen nga Ministri i Financave dhe i Ekonomisë me pranimin e arsytimit të duhur, pas marrjes së miratimit nga Qeveria dhe

(c) Transferimet e shumave nga “Rezerva për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm” autorizohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 9 Transferimi i shumave të ndara

9.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, pas konsultimeve me Qeverinë, mund të autorizojë një transferim të shumave të ndara midis tabelave A, B dhe C të pasqyrës 2.

9.2 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë, nëse ka një arsyetim valid nga drejtori i organizatës buxhetore, mund të autorizojë transferimin e një pjese të një ndarjeje për atë organizatë buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore, në përputhje me nenin 27 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut.nr. 2003/17.

9.3 Pavarësisht nga neni 9.2, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, me kërkesë të drejtorit të organizatës buxhetore të kompetencave të rezervuara mund të autorizojë transferin e shumës më të madhe se njëzet për qind (20%) të ndarjeve të prekura negativisht të asaj organizate, pas konsultimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

9.4 Pas miratimit duhet të bëhet përmirësim i shumave të ndara në pasqyrën 2 në Regjistrin kontabël të Thesarit nga ana e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Këto ndryshime duhet të përfshihen në rishikimin e ardhshëm të pasqyrave buxhetore të miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në përputhje me nenin 3.

Neni 10 Kredi për subjekte të caktuara

Në pajtim me nenin 44.4 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17 dhe të ndryshuar më vonë, Ministri i Financave dhe i Ekonomisë do të sigurojë kredi apo hua të kthyeshme nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës për subjekte të caktuara të specifikuara në numrin 3 dhe 4 të pasqyrës A të Ligjit. Shumat për çdo kredi apo hua të kthyeshme të miratuara, siç është përcaktuar në pasqyrën 2 të tabelës A, do të ndahen sipas rregullit në bazë të marrëveshjes ndërmjet subjektit të caktuar, i cili e merr kredinë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Neni 11

Shuarja e fondeve dhe ndarja e mjeteve buxhetore

Përveç rasteve kur kjo Rregullore parasheh rindarje të mjeteve buxhetore, ndarjet e mjeteve buxhetore dhe rishpërndarjet e fondeve të bëra në vitin fiskal 2005 shuhen automatikisht në mesnatën e 31 dhjetorit të vitit 2005, përveç kur Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në rrethana të jashtëzakonshme me kërkesë të Qeverisë, mund të autorizojë ndryshe

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars të vitit 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Pasqyra 1

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës 2005

(bashkëngjitur)

Pasqyra 2

Ndarjet e Buxheti të Përgjithshëm të Kosovës 2005

(bashkëngjitur)

Tabela A: Organizatat buxhetore të Qeverisë së Përkohshme

Tabela B: Organizatat buxhetore që janë komuna

Tabela C: Përmbledhje e ndarjeve

Tabela E: Organizatat buxhetore të Qeverisë Qendrore

Pasqyra 3

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2005

Financim me ndarje të drejtë. Propozimi për kërkesat minimale të ndarjeve

(bashkëngjitur)